

Fakulteti: Fakulteti i shkencave sociale

Lënda: Lojërat dhe lodrat, Profesori i lëndës, Mr. Emrush Xhemajli

Java VI

## **Njesia: LOJERAT FEMINORE DHE KLASIFIKIMI I TYRE**

Në literaturën pedagogjike dhe psikologjike hasen klasifikime të ndryshme mbi lojërat e fëmijëve parashkollorë. **Shterteri**<sup>1</sup> lojërat e fëmijëve i klasifikon në dy grupe të mëdha:

- A. Grupi i lojërave të fëmijëve në vetmi; dhe**
- B. Grupi i lojërave shoqërore.**

### **A. Grupi i lojërave të fëmijëve në vetmi**

Në grupin e lojërave në vetmi fëmija luan pa partner dhe ato mund të ndahen në tri grupe:

- a. Lojërat e zotërimit të trupit të vet;** (ndryshe lojërat funksionale – trupore - motorike dhe shqisore (sensorike).
- b. Lojërat e zotërimit të sendeve; dhe**
- c. Lojërat e të perzantuarit (luajtja e roleve)**

#### **1. Lojërat e zotërimit të trupit të vet –**

Gjatë këtyre lojërave fëmija e shpreh nevojën e vet për t'a zaptuar hapësiën. Këto lojëra mbështeten në gjymtyrët e fëmijës, i cili i imiton disa vperime, kuse qëllimi i tyre

<sup>1</sup> Viliam Shterteri, psikolog gjerman që theksoi rëndësinë e trefishtë të lojës në aspektin e të kaluarës, të tashmës dhe të së ardhmës (pajtues i teorive biologjike lidhur me lojën).

qëndron në atë që lëvizjet e veta fëmija t'i vejë nën kontrollin e tij. Lojëra të tilla janë: heqja, venja (vendosja), kërçimi, ngjitja etj.

## 2. Lojërat e zotërimit të sendeve.

Te lojërat e zotërimit të sendeve Shternerit, i heton dy variante:

- a. **Lojërat ku përdorimi i sendeve shërben, si rikuizite të lojërave trupore;** dhe
- b. **Lojërat ku bëhen përpjekje që sendet të ndysohen** (kërkimi dhe hulumtimi i sendeve).

Gjatë këtyre lojërave mund të pikaset aftësia e fëmijës. Gjithnjë sipas Shternerit, këto lojëra kanë rol të madhe gjatë procesit të të mësuarit të fëmijëve. Cilësi tjetër vijuese e këtyre lojërave është **Konstruksioni. Lojërat KONSTRUKTIVE** janë tejet të rëndësishme për sintezën shpirtërore, pastaj për adaptimin e fëmijëve në aktivitete të orientuara. Gjatë lojërave të tilla përformohet një motiv kreativ. **Shternerit** konsideronte se gjatë këtyre lojërave mund të pikasen dallimet mes fëmijëve për kah gjinia, e sidomos gjatë lojërave konstruktive, ngase tek djemtë shprehet nevojë më e madhe për të krijuar apo bërë diç, kurse tek vajzat më tepër dominon nevoja për të imituar. Shterni kujdes të veçantë i kushtonte lojërave konstruktive dhe ai ishte kundërshtar i rreptë për t'iu përzier fëmijës (në kuptim të ndihmës) gjatë lojës.

### c. **Lojërat e prezantimit (luajtja imagjinare e nje roli)**

Gjatë lojërave me role interesimi i fëmijëve është i orientuar kah uni personal i tij. Për këtë arsye kualiteti i posçëm i këtyre lojërave është metamorfoza e personit. Prandaj, shih për këtë arsye Shternerit iu bëri kritikë, paraardhësve të cilët kufizoheshin vetëm në këto lloje të lojërave.

**Fëmija më së shpeshti i luan ato role nga të cilat frikësohet**, ngase kjo është edhe e vetmja mënyrë për ta zotëruar atë frikë. Sipas **Shternerit**, fëmija luan për t'iu përjetuar disa emocione. Zgjedhja e rolit dhe luajtja e atij roli nga ana e fëmijës, ka rëndësi të madhe për emancipimin e pjekurisë, emancipim ky tek i cili fëmija e gjen një komprenzim për inferioritetin e tij dhe kështu ai e përjeton njëfarë kënaqësie. **Shternerit lojërat e vetmuarai quan lojëra të maskuara**

**shoqërore**, spese edhe nëpërmjet lojërave të tilla fëmija i interpreton disa sjellje ose shfaqje shoqërore.

## **B. Grupi i lojërave shoqërore**

Në këtë grup lojërash partnerët e parë në lojën e fëmijës janë njerëzit e rritur. Në lojëra të tilla fëmijës i ofrohen disa kërkesa shoqërore. Fëmija gati është i indentifikuar me të rriturit. Miërëpo, gjatë zhvillimit të fëmijës rritet edhe nevoja e tij për të luajtur me bashkëmoshatarët e tij, të cilët i zëvendësojnë të rriturit.

**Frebeli**<sup>2</sup> lojërat e fëmijëve i klasifikoi në:

- a. Lojëra fizike, motorike (zhvillim i trupit)
- b. Lojërat sensorike (zhvillimi i shqisave); dhe
- c. Lojëra kuptimore – (zhvillimi i aftësive intelektuale)

Në klasifikimin e lojërave ze vend me rendesi dhe **GANJELINA** sepse ajo kishte parasyshë kriterin e **NDIKIMIT EDUKATIVO-ARSIMOR TË LOJËRAVE**

Ajo lojërat e klasifikoi në:

- A. **LOJËRAT KREATIVE** ( te studjues tjerë këto quhen lojëra të roleve e të fantazisë)
- B. **LOJËRAT LËVIZËSE**
  - a. Lojërat lëvizëse me përmbajtje dhe
  - b. Lojërat lëvizëse pa përmbajtje.
- C. **LOJËRAT DIDAKTIKE** (te studjues tjera këto quhen lojëra me rregulla, lojëra intelektuale...)

<sup>2</sup> Fridrich Freble (1782-1852) pedagog gjermani aplikues i metodës “dhuaratat lojë”

Ndërsa **Piazhe**<sup>3</sup> lojërat i klasifikoi kështu:

- a. Lojërat funksionale, senzoro-motorike**
- b. Lojërat simbolike**
- c. Lojërat me rregulla; dhe**
- d. Lojërat konstruktive**

### **1. Lojra, funksionale - trupore dhe sensoriale ( shqisore)<sup>4</sup>**

Mesimin e tij te pare me ane te lojes femija e merr qysh ne djep me ane te levizjeve te rastesishme dhe te zbulimeve qe ai bën. Bebja nuk e kupton qe ato pese topat e vegjel ngjyre roze qe levizin jane gishtat e tij te kembes. Duke futur ne kujtese kontrollet muskulore qe vene ne levizje keto topa ai zbulon potencialin e tij dhe qe ne kete moment ai do te levize ne menyre te qellimshme dhe do te ndjeje kenaqsi duke perseritur keto gjeste. Keshtu ai luan. Me vone ai do te kape kembet e tij, do t'i fuse ne goje , do t'i thithe dhe do t'i kafshoje. Lojrat e levizjes kerkojne perdorimin e trupit te femijes, praktiken e zoterimit te muskujve dhe eksperiencen e kenaqesise qe rrjedh nga keto. Tek femijet fare te vegjel, por edhe tek femijet pak me te rritur, vihet re kjo eksperience arbitrare e funksioneve trupore. Femija ecen shpejt, vjen njezet here rrotull tavolines, terheq pas vetes nje kal me rrota apo nje makine, mbush koven me rere dhe e zbras menjehere. Me ose pa material femija nxjerr ne pah potencialin e tij motorik. Per me teper ai fiton nje imazh gjithnje e me shume preciz te botes qe e rrethon. Femija qe rritet eksploron hapesiren dhe objektet qe e rretojne ne funksion te levizjes. Ketu po japim nje liste me ato qe femija mund te perdori per te manipuluar, per tu ngjitur, per tu hedhur, kercyer , terhequr, shtyje,transportoje etj.

- lendina,fusha,pylli,rruga

- peme,dege

<sup>3</sup> Jean Piaget (Zhan Piazhe) psikolog zviceran (përfaqësues i teorive konjitive lidhur me lojërat fëmijërore).

<sup>4</sup> Pjesa e njësisë për mendimet e Pjzhesë për klasifikimin e lojërave është krahasuar me literature shtese ndersa është bazuar ne autorin Viktor Lami / SPS / Analiza e praktikës / leksione

- gure, shkopinj
- arka, kuti, derrasa
- pellg me uje, balte, debore, rere
- shtepi, mure, dyer, dritare, shkalle
- qilima, tapete
- tavolina, karrike, dollape te klases
- dysheke, jastek
- canta, qeska, litare

Femijet me te rritur qe kane me shume imagjinate mund te perdorin objekte te tjera per kete forme loje, si :

- trampolina
- litare per tu ngjitur
- pishine, gropa me rere
- bicikleta, makina
- kuaj prej druri
- kafshe te ndryshme me rrota
- topa,ballona te fryre
- birila,unaza per te hedhur
- lopata
- borije,zile,
- vegla te ndryshme muzikore, etj.

Shume shpejt femija tregohet kurioz. Te gjitha shqisat e tij zgjohen. Duart etij te vogla eksplorojne, syte e tij te vegjel mrekullohen,veshet ngrihen perpjete nga zhurma me e vogel, goja e tij behet llupese dhe hunda e tij u merr ere nje mije e nje aromave.

Perse te mos e ndihmojme femijen per te zhvilluar te gjitha shqisat e tij ? Kjo perpjekje eshte themelore. Duhet ti japim femijes rastin te takoje shumellojshmerine e materialeve dhe lendeve :

- rere, uje, balte, debore
- gure, dege peme, pupla, gjethe, lule

-shkopinj, derrasa, kuti

-lecka, litare

-tapa shishe

Dhe ketu femijet me te rritur sjellin kontributin e tyre me objekte te ndryshme :

-kova, kallep (forma) lopata, kreher

-instrumenta muzikore

- blloqe per te ndertuar

-perla per te shkuar ne fill (pe), mozaik

-pelhure, lesh, fill, gjilpere

-lapsa, kolora, pastel, bojra

-ngjites, gershere

-leter, karton

-shkumes

-argjil, plastik

-derrasa, vegla marangozi, etj.

## **2. Lojrat simbolike, te fantazise**

Kjo forme loje eshte studjuar ne psikologji me termat : loje me role, loje imagjinuese, loje identifikuese ose loje imituese. Me ane te ketyre lojrave femija imiton jeten ne te gjitha aspektet emocionale dhe sociale. Kjo loje eshte teper e ngarkuar ne planin afektiv. P.sh femija e ben kukullen si beben e vet dhe i kerkon nenes se vet te luaj rolin e gjyshes, baby-sitter , te kujdeset per beben e vet.

Gjate lojes simbolike femija ne menyre imagjinative imiton realitetin. Ne pjesen me te madhe te kohes ai eshte aktori kryesor. Ai do t'u jape jete kukullave, do t'i beje ato te flasin e te levizin sipas nevojave te fantazise se tij. Keto lojra i lejojne femijes qe te behet rregjizor.



Ai rregullon, modifikon , manipulon te gjitha llojet e mobiljeve te vogla, makinave, personazheve, kafsheve si ne nje spektakel te vertete.

Mund te perdoren elemente te mjedisit qe na rrethon per te mbledhur materiale .

Ne keto lojra ka rendesi perpjekja dhe jo rezultati.

### **3. Lojrat me rregulla, të kooperimit ( bashkepunimit) :**

“Lojrat me rregulla eshte aktiviteti i qenies se shoqerizuar”<sup>5</sup>.

Kjo loje lufton ngulitjen e egocentrizmit ( unit ) tek individi. Ne saje te lojrave me rregulla dhe te bashkepunimit femija behet me pak subjektiv, merr ne konsiderate tjetrin. Ai e konsideron si nje partner te ndryshem nga vetja e tij, qe ka identitetin e vet.

Shembuj :

- ne ndarjen e roleve ne nje pjese teatri
- ne lojrat e kenduara
- ne lojrat e tavolines : loje me letra, domino, mos-u-nxe njeri
- ne lojrat ne natyre

### **4. Lojrat eksperimentuese :**

Keto lojra i lejojne femijes te shtroje dhe te zgjidhe probleme te karakterit me shkencor, matematik.

<sup>5</sup> Psikologu i cituar më lar. Zh. Piezhe

Ato lejojne gjithashtu te stimulohet kurioziteti, p.sh duke konstatuar transformimet fizike. Ne zbulimin e situatave problemore femijet ndertojne konceptet e para dhe format e arsytimit qe do t'u lejojne me vone te futen ne dijet shkencore e matematikore.



#### 4.1.Elemente per te zbuluar, ndertuar, shkaterruar, transformuar :

-Legen me uje : hinke,mulli me uje,tapa shishe, tuba fleksibel te diametrave te ndryshem

- Te konstatoje vetite e ujit : lundrimi, enet komunikuese, transformimet ( ngrirja, vlimi, avullimi)

-Me peshore :

- Te peshoje, shtoje, heq

- lende te pandashme : mielli, rera, uji, sheqeri...

- lende te ndashme : fara, fruta te thata, tapa...

- Me ajrin :

- Zhvendosjet ne saj te ajrit te ngrohte, rezistenca e ajrit...

- Te beje flluska, te shuaje qirinjte e tortes, te fluturoje nje pupel duke i fryer...

-Me tuba,cilindra

-Me leter ambalazhi

-Me magnet

-Me drite dore

-Me susta



-Me driten dhe hijen



## **5. Lojra komunikuese : jo verbale, gojore, te shkruara**

Te gjithë femijet janë social. Ata reagojnë ndaj zërit të njeriut, fytyrës së njeriut, veprimeve dhe gjesteve njerëzore, por ata janë njëkohësisht agjent aktiv ndërsa provokojnë të rriturin me anë të bertiturave, mimikave ose lojrave.

Ata janë ” qenie komunikuese”

### **5.1.Lojra komunikuese jo verbale :**

*”Qysh në muajt e parë të jetës lojrat i lejojnë femijes të zbulojë dhe kuptojë botën, të ushtrojë kompetencat e tij, të vendosë lidhje me mjedisin që e rrethon... pa folur për kenaqesinë që provokojnë lojrat”<sup>6</sup>*

#### **1.Me zërin**

<sup>6</sup>A. Florin Laboratori i psikologjisë ,Universiteti Nantes

- Te terheq vemendjen me ane te britmave, te qaret, te qeshurat
- Te imitoje miaullimen e maces, te lehurin, hingellimen, te imitoje zhurmen e lokomotives,te avionit, te makines se rrojës.
- Te ndryshoje intonacionet : urdher,kerkese,zemerim, padurim..

## **2. Me trupin dhe mimikat**

Duke komunikuar me te tjeret femija zbulon trupin e tij.

Trupi dhe mimikat i sherbejne femijes per te shprehur ndjenjat e tij : ankthi, frika, zemerimi, p.sh. imiton luanin duke ecur kembadorazi

Mjete te tjera shprehese jane : te luaj me trupin e tij perpara pasqyres, te krijoje ritme

## **5.2. Komunikimi gojor (oral) dhe i shkruar:**

Gjuha e folur dhe e shkruar eshte nje instrument komunikimi. Femija mund ti mesoje ato vetem duke i perdorur.

Keto lojra kerkojne te jene te pakten dy vete :

- Dialog midis dy marionetave (kukullave)
- Te luash ne telefon me nje korrespondent
- Te luash postjerin
- Te dramatizosh nje histori
- Loja e telefonit te prishur

**Kombinim i lojës Lëvizëse (senzoro motorike) dhe simbolike, të fantazisë(fëmijët i kanë hipur në një krijesë dhe po e kaluarojnë ate.**

Ne fund duhet thene se disa nga lojerat e fantazise, te zhvillimit senzoro-motorik dhe lojes me rregulla etj. Mund të luhen dhe ne kompjuter<sup>7</sup>

---

<sup>7</sup>Njesi e vecante do t'u kushtohet Lojerave dhe Lodrave elektronike